



Pranimar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	13.04.2021	1	viti god year
Organ /Ijesta Organ /Jedinstva Org /Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	1757/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.166/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit numër A.nr.1652/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 05.03.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.217/2020 të 06.08.2020, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Rruga “Shaqir Igrishta”, Kompleksi Dafina, hyrja 2/3 nr.10, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komisionit të Pavarur për Media, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.217/2020 e datës 06.08.2020, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.08.2020 dhe numër protokoll: 1481/2020 kundër Vendimit me numër Nr:211-KA-2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit të Pavarur të Mediave të datës 09.07.2020, për shkak të mos aprovimit të kërkesës për pushim pa pagesë me qëllim të përfundimit të studimeve jashtë vendi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.08.2020, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit te Komisionit i Pavarur i Mediave. Këshilli me datë 20.08.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1593/2020 se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 11.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për

Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 05.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1652/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 11.09.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 06.08.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll: 1481/2020 të datës 06.08.2020 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër: 2007/544/KZKA/ni të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 09.07.2020; Ankesën e ankueses të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 03.04.2020; Vendimin me numër:2003/365/EXD/II të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave të datës 23.03.2020; Kërkesën e ankueses të për pushim pa pagesë drejtuar Udhëheqësit të Departamentit për Monitorim dhe Analizë të datës 02.03.2020 me numër Ref:2003/258/DMA; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.08.2020; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.08.2020 me numër protokoll:1593/2020 me faqe 1/21; E-mailin e datës 10.07.2020 dërguar nga për Vërtetim e datës 05.03.2020 me numër ID:128244 të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë me shtesën e bashkangjitur me numrin e ECTS Credits 60: Shkresën e datës 04.03.2020 dërguar për E-mailin e datës 16.03.2020 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Aktgjykimin me numër A.nr.1652/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 05.03.2021, Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 11.09.2020 me numër protokoll:1723/2020.

Kolegji për shqyrtimin dh vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar kompetencat e tij dhe pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesja me datë 02.03.2020 ka parashtruar kërkesë për pushim pa pagesë të Udhëheqësi i Departamentit për Monitorim dhe Analizë/KPM për periudhën kohore prej datës 01.04.2020 deri më datë 31.03.2021, ndërsa me datë 23.03.2020 Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur të Mediave ka nxjerr vendimin me numër 2003/365/EXD/II dhe e ka refuzuar kërkesën e ankueses për pushim pa pagesë të datës 02.03.2020.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesja me datë 03.04.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kundër vendimit me numër 2003/365/EXD/II të datës 23.03.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv, ndërsa Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka refuzuar ankesën e ankueses përmes Vendimit me numër:2007/544/KZKA/ni të datës 09.07.2020 me këshillën juridike se pala ka te drejt ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kolegji me qëllim të vendosjes në mënyrë meritore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)” si dhe neni 127 paragrafi 4 i cili përcakton se: “Ankesa kundrejt heshtjes




administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrative”, si dhe neni 135 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, përcakton se: “Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës”, po ashtu dispozitat e këtij ligji e përcaktojnë qartë se kur një akt administrativ është i paligjshëm dhe nuk prodhon efekte juridike siç përcaktohet në nenin 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe 1.6 si në vijim: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1 është rezultat i shkëljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.6 është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”.

Andaj me këtë rast, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se institucioni punëdhënës respektivisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka qenë i obliguar ligjërisht që ankesën e ankueses të datës 03.04.2020 ta trajtoj dhe brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti i parashtrimit të saj të nxjerr aktin administrativ që zgjidh ankesën siç e përcaktojnë dispozitat e Rregullores Nr.5/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave neni 9 paragrafi 7 i cili përcakton se: “Komisioni duhet të merr vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës”, andaj me këtë rast institucioni ka krijuar heshtje administrative e që për palën-ankuesen afati për heshtje ka filluar t’i rrjedh nga data 09.05.2020 dhe ka përfunduar me datë 01.07.2020 e drejtë kjo e cila nuk është shfrytëzuar nga pala edhe pse dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 4 e garanton këtë të drejtë në një procedurë administrative.

Po ashtu, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave vendimin me numër: 2007/544/KZKA/ni të datës 09.07.2020 e ka nxjerrë në kundërshtim me dispozita e Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative neni 135 paragrafi 1, pasi që institucioni nuk ka nxjerr vendim paraprak për shtyrje të afatit për vendosje siç e përcaktojnë dispozita e Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative neni 99 paragrafi 1 dhe 2 “1.Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligj; 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar”, andaj mbi bazën e kësaj Kolegji konstaton se ankesa e ankueses është e pabazuar pasi që si ka respektuar afatet për heshtje administrative siç e përcakton neni 127 paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa akti administrativ respektivisht vendimi me numër: 2007/544/KZKA/ni i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 09.07.2020 i cili është atakuar me ankesën e ankueses të datës 06.08.2020 në Këshill, është i paligjshëm dhe si i tillë nuk prodhon efekte juridike pasi që është nxjerrë në kundërshtim me afatin kohor të paraparë në nenin 135 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë duhet shfuqizuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit të Pavarur të Mediave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 2007/544/KZKA/ni të datës 09.07.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative si dhe dispozitat e Rregullores Nr.5/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, pasi që nuk ka respektuar afatet e përcaktuara kohore të nxjerrjes së aktit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.166/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi
- Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave;
- Udhëheqësit të Personelit të Komisionit të Pavarur të Mediave, dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

